

dhjetor 2021

Zaklan kundër Kroacisë - 57239/13

Vendim 16.12.2021 [Seksioni I]

Neni 1 i Protokollit nr. 1

Neni 1 para. 1 i Protokollit nr. 1

Qëzimi paqësor i pronës

Shtyrja e tejzgjatur e proceseve gjyqësore nga shtetet që kanë qenë më parë pjesë e një federate pengojnë kërkuuesin të marrë paratë e konfiskuara përkohësisht nga ish-Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë: *ka shkelje*

Faktet – Kërkuesi është shtetas kroat. Në vitin 1991, autoritetet doganore të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ("RSFJ") i konfiskuan atij përkohësisht shuma monetare në kufirin midis RSFJ-së së atëhershme (tani Kroacia) dhe Hungarisë për përpjekjen për të nxjerrë paratë përtej kufirit shtetëror, në kundërshtim me ligjin. Ndaj tij në të njëjtin vit filloi procedimi për kundërvajtje administrative.

Pas kësaj, Kroacia shpalli pavarësinë dhe ndërpreu të gjitha lidhjet me RSFJ-në. Në vitin 1992, qeveria e Kroacisë nxori një dekret me anë të së cilit ajo pezulloi të gjitha proceset administrativo-kundërvajtëse ende të pazgjidhura deri në përfundimin e procesit të shkëputjes pas shpërbërjes së RSFJ-së. Në vitin 2004, hyri në fuqi Marrëveshja për Çështjet e Trashëgimisë ndërmjet shteteve pasardhëse të RSFJ-së.

Ndërkohë, proceset administrative për kundërvajtje të kërkuetit u parashkruan. Kërkuesi hapi një proces civil të pasuksesshëm përmes të cilit kërkonte kthimin e parave. Gjykata kombëtare vlerësoi se kërkuesi mund të ngrinte një padi të tillë vetëm pasi të kishte përfunduar procesi administrativ për kundërvajtje, dhe vetëm në rast se vendimi përfundimtar nuk kishte urdhëruar konfiskimin e përhershëm të këtyre shumave. Meqenëse çështja e kërkuetit ishte pezulluar, ato procese nuk kishin përfunduar dhe veprimi i tij kundër shtetit kishte qenë i parakohshëm. Kërkuesi e apeloj vendimin, por pa sukses.

Baza ligjore – neni 1 i Protokollit nr. 1:

(a) Nëse shkelja e pretenduar mund t'i atribuohet shtetit të paditur

Qeveria kishte argumentuar se shkelja e pretenduar nuk mund t'i atribuohet shtetit të paditur pasi ajo kishte ardhur si rezultat i veprimeve të ndërmarra nga autoritetet federale të ish-RSFJ-së përpara se Kroacia të shpallte pavarësinë, dhe për shkak se Kroacia nuk kishte marrë përsipër proceset administrative për kundërvajtje që ish-autoritete federale kishin ngritur kundër kërkuetit.

Në lidhje me këtë, Gjykata fillimisht vuri në dukje se kërkuesi nuk ishte ankuar për konfiskimin e përkohshëm, por, përkundrazi, pretendimi i tij kishte të bënte me pamundësinë për të rikuperuar shumat e konfiskuara pasi vepra administrative për të cilën ishte akuzuar ishte parashkruar.

Situata për të cilën ankohej kërkuesi u atribuohet autoriteteve kroate, në bazë të përfundimeve të mëposhtme të Gjykatës:

Autoritetet kroate kishin marrë përsipër procesin administrativ kundër kërkuetit nga autoritetet federale të ish-RSFJ-së. Argumenti i qeverisë për të kundërtën ishte jo bindës duke pasur parasysh provat e shumta që ekzistonin për këtë qëllim, duke përfshirë referencat përkatëse të ligjit kombëtar dhe korrespondencën midis autoriteteve të ndryshme financiare kroate dhe ministrit të Financave të Serbisë;

Që nga ai moment proceset ishin zhvilluar në përputhje me ligjin material dhe procedural kroat që rregullon kundërvajtjet administrative;

Këto procese ishin pezulluar nga autoritetet kroate dhe kishin mbetur të pezulluara deri në ditët e sotme, gjë që kishte çuar në parashkrimin e kundërvajtjes administrative për të cilën kishte ngritur padi kërkuesi;

Sipas ligjit kroat dhe atij serb, sendet e konfiskuara përkohësisht duhej të riktheheshin pasi vepra në fjalë të ishte parashkruar; megjithatë

pezullimi i proceseve i vendosur nga legjislacioni kroat kishte penguar autoritetet përkatëse të nxirrnin një vendim për të pushuar procedurën administrative kundër kërkuetit, gjë që e kishte penguar atë të rimerrte paratë e konfiskuara përkohësisht si nga autoritetet kroate, ashtu edhe nga ato serbe.

Duke qenë se Serbia nuk ishte palë në proceset që kërkuesi kishte nisur para Gjykatës, Gjykata nuk mund të prononcohet për çështjen nëse Serbia kishte gjithashtu përgjegjësi lidhur me situatën e shkaktuar.

Për rrjedhojë, kundërshtimi i papranueshmërisë nga qeveria në lidhje me papajtueshmërinë *ratione materiae* duhej të hidhej poshtë.

(b) Nëse pamundësia e tejzgjatur e kërkuetit për të rimarrë paratë e konfiskuara përkohësisht ishte në përputhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1

Paaftësia e tejzgjatur e kërkuetit për të rimarrë paratë duhej të shqyrtohej në dritën e parimit të përgjithshëm të përcaktuar në rregullin e parë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 (gëzimi paqësor i pronës). Nuk ishte e nevojshme të kategorizohej kjo paaftësi si një ndërhyrje, një dështim për të përmbushur detyrimet pozitive të shtetit sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1, ose një kombinim i të dyjave. Pavarësisht nga kategoria ku bënte pjesë, Gjykata duhej të shqyrtonte nëse ajo kishte qenë në përputhje me atë nen, domethënë, nëse kishte qenë e ligjshme, nëse kishte ndjekur një qëllim që kishte qenë në interesin e përgjithshëm dhe nëse ishte gjendur një "ekuilibër i drejtë" ndërmjet interesit të përgjithshëm në fjalë dhe të drejtave pronësore të kërkuetit.

Paaftësia e kërkuetit për të rimarrë paratë si rezultat i pezullimit të procesit për kundërvajtje administrative ishte parashikuar me ligj dhe ndiqte një qëllim që kishte qenë në interes të përgjithshëm, përkatësisht atë të mbrojtjes së portofolit publik dhe ekonomisë kombëtare.

Ndërkohë që disa vonesa mund të justifikoheshin për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, kërkuesi ishte detyruar të priste shumë gjatë. Për më tepër, pezullimi i tejzgjatur i procesit e kishte penguar atë që të kërkonte kthimin e shumave të konfiskuara

përkohësisht jo vetëm nga autoritetet kroate, por edhe nga ato serbe. Parandalimi i kërkuesit për të kërkuar kthimin e parave nga Serbia vështirë se mund të justifikohet me qëllimin e mësipërm për mbrojtjen e portofolit publik dhe ekonomisë kombëtare.

Për më tepër, në çështjen *Ališić dhe të tjerët kundër Bosnje dhe Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe "ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë"* [DHM], negociatat e trashëgimisë nuk i kishin penguar shtetet pasardhëse të ndërmarrin masa në nivel kombëtar me synim mbrojtjen e interesave të individëve brenda juridiksioneve të tyre përkatëse. Për qëllimet e çështjes në fjalë, ishte e rëndësishme që Kroacia të kishte marrë gjithashtu përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga autoritetet e ish-RSFJ-së për aq sa ajo kishte lidhjen më të ngushtë me dëmin, veçanërisht, kur veprimi i gabuar kishte ndodhur në territorin e saj dhe viktimat kishte qenë shtetas kroat. Kjo tregon se janë gjetur zgjidhje për disa kategori individësh, të drejtat e të cilëve ishin prekur nga shpërbërja e ish-RSFJ-së, por jo në lidhje me kërkuesin në fjalë.

Për rrjedhojë, Gjykata nuk u bind që autoritetet kroate, pavarësisht nga pragu i tyre i gjerë i vlerësimit, kishin vendosur një ekuilibër të drejtë midis interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe të drejtave pronësore të kërkuesit, i cili ishte detyruar të mbante një barrë joproporcionale.

Përfundim: ka shkelje (me unanimitet).

Neni 41: 1,327 për dëme jopasurore.

(Shih gjithashtu *Ališić dhe të tjerët kundër Bosnje dhe Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe "ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë"* [GC], 60642/08, 16 korrik 2014 [DHM], 60642/08 [Legal Summary](#))

Këshilli i Evropës/Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Kjo përmbledhje e Sekretarisë nuk është detyruese për Gjykatën

Klikoni këtu për më shumë informacion rreth [Case-Law Information Notes](#)